

Si të ndërtohet me SILKA?








xella

silka

Blokat Silka të fabrikës Xella

Fabrika Xella në Lipjan prodhon blloka dhe tulla silikate të formateve të llojllojshme. Ato përbëhen prej rëres silikate, gelqeres dhe ujit.

Emërtimi i produkteve dhe dimensionet



Blokat 6 DF, 7DF dhe tulla 3DF mund të përdoren për mure të jashtme dhe të brendshme. Blloku 8DF (115) është bllok i mureve të brendshme ndarëse, por mund të përdoret edhe për mure të jashtme në çift, varësisht nga kërkesat.

Blloku 8DF (240) përdoret për mure të podrumeve, mure masive të objekteve deri në 2 kate si dhe për muret me sipërfaqe të mëdha apo për kërkesa të larta të vetisë së zë-izolimit.

Tullat dekoruese 2DF dhe NF në kombinim ose te veçanta përdoren kryesisht për mure dekoruese (kamin, banak etj.) si dhe për oxhak klasik.

Si të punohet lehtë dhe shpejtë me bllokat Silka



Bllokat e formateve të mëdha janë të pajisura me dhëmbëzore në të dy anët me të cilët lidhen në mes veti (pa fugë llaçi vertikal). Lidhja e fugave përcillet sipas nevojës dhe bllokat vendosen volitshëm në shtresën e llaçit.



Aplikimi i rendit të parë

Rendi i parë i murit aplikohet me llaç normal kurse rendet tjera në vazhdim të mureve murosen me ngjitës. Mbi llaçin normal të shtruar vendoset blloku Silka. Korrigjohet me çekan gome derisa të arrihet plan i rrafshët horizontal dhe vertikal.



Llaçi shtresëhollë (ngjitësi)

Përgatitet dhe shtrihet përgjatë bllokave të renditur. Preferohet të punohet me ngjitës Silkafix 10. Shpërndarja e ngjitësit më së miri është të bëhet me lopatë adekuate me dhëmbëzore.

Pas shtrirjes së ngjitësit mbi bllokun e rendit më të ulët bëhet radhitja e bllokave të rendeve në vijim shpejtë dhe saktë.



Muri nga blloku Silka ndërtohet ngajshëm sikur muret tjera për $\geq 0,4$ h deri $1/2$ e bllokut duke i lidhur rendet.

Vendosja e trajeve mbi dyer dhe dritare

Trajat e dimenzioneve të ndryshme nga betoni i armuar, të përpunuar në fabrikë, ndihmojnë në konstruksionin e murit dhe shpejtojnë punën në aplikim. Ata vendosen lehtësisht mbi dyer dhe dritare.



Vendosja e kabllave të rrymës nëpër vrimat e bllokave

Nëse muratura është kryer ne rregull, vrimat e bllokave puthiten në mes vete dhe krijojnë kanale brenda murit.

Nëpër këto kanale mund të shperndahen lehtëazi kabllot e rrymës. Kështu do të kurseni kohë dhe energji që në raste tjera do të duheshin për të bërë gërryerje të murit enkas për vendosje të kabllave të rrymës.



Suvatimi

Falë vetive lidhëse që kanë bllokat Silka, të gjitha llojet e suvave mund të aplikohen pa ndonjë shtresë ndërlidhëse në mes murit dhe suvasë. Kjo bën që të kursehet drejt për se drejt fuqia punëtore si dhe ulë shpenzimet në material suvatues.



Veglat për zbatim murature



Përziersja elektrike e llaçit




Makina për hapjen e kanaleve



Vegël llaç-shpërndarëse



Vegël llaç-shpërndarëse



Prerëse manuale e bllokut

Xella Kosova L.L.C.,

Rr. e Martirëve p.n.

14 000 Lipjan

Republika e Kosovës

tel. +381 (0)38 580 161

fax. +381 (0)38 580 164

info.kosova@xella.com

www.kosova.xella.com